



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:226529
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05845706

KPPP.nr.1046/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Glam Radio” Sh.p.k., me NRB:71278220, me seli në Prishtinë Rr.”Ahmet Krasniqi” nr.55-1, nr.7 të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Adelina Isufi avokate nga Prishtina Rr.”Rexhep Luci” H20, Kati III-të, nr.11, ndaj debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën për parregullsi të debitorit të ushtruar kundër veprimeve përmbartimore të përmbartuesit privat Ilir Z. Mulhaxha, në çështjen përmbartimore të evidentuar sipas numrit P.nr.585/18 të datës 11.07.2018, me datën 21.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar Ankesa për parregullsi e Debitorit Telekom i Kosovës Sh.A., me të cilën ka kërkuar anulimin e veprimeve të ndërmarra nga përmbartuesi privat Kushtrim Metaj në çështjen përmbartimore P.nr.585/18 të datës 11.07.2018.

A r s y e t i m

Debitori Telekom i Kosovës Sh.A., ka paraqitur ankesë lidhur me parregullsitë e përmbartuesit privat Ilir Mulhaxha, gjatë kryerjes së veprimeve përmbartimore në lëndën me numër P.nr.585/18 të datës 11.07.2018, duke kërkuar nga Gjykata që të aprovohet si e bazuar ankesa e Debitorit, të konstatoj parregullsitë dhe konform gjendjes faktike të nxjerr aktvendim me të cilin do ti konstatoj këto parregullsi dhe konform gjendjes së konstatuar dhe dispozitive ligjore të shfuqizoj Urdhrin Përmbartimor P.nr.585/18 të datës 11.07.2018, si dhe të abrogoj të gjitha veprimet e ndërmarra nga përmbartuesi privat Ilir Mulhaxha. Ndër të tjerash ka theksuar se kundër urdhrit për përmbartim debitori ka paraqitur prapësim pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 16.07.2018, ndërsa kjo gjykatë me datë 29.06.2020, ka nxjerrë aktvendim

PPP.nr.881/18, me të cilin ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit. Ndërsa debitori duke shfrytëzuar të drejtën në Këshillën Juridike me datë 10.08.2020, ka paraqitur ankesë kundër aktvendimit me arsyet si në ankesë. Ka shtuar se edhe për kundër faktit se përmbaruesi privat ka bërë shkelje ligjore lidhur me caktimin dhe lejimin e Urdhrit Përmbarimor, ngase ka lejuar përmbarimin në bazë të kopjeve të faturave të pa vërtetuara, ku debitori ka ushtruar ankesë kundër aktvendimit dhe Gjykata e Apelit të Kosovës ende nuk ka vendosur lidhur me ankesën e debitorit, përmbaruesi privat Ilir Mulhaxha në ndërkohë ka nxjerrë edhe Urdhrin Konkluzionin e datës 23.03.2021, me të cilin ka urdhëruar Raiffeisen Bank në Prishtinë që sipas përmbaruesit privat është i formës së prerë pas refuzimit të prapësimit nga gjykata. Tutje ka theksuar se Raiffeisen Bank në Prishtinë me urdhrin e përmbaruesit privat ka tërhequr mjetet nga llogaria e debitorit, andaj debitori ka analizuar veprimet e përmbaruesit privat lidhur me parregullsitë e tij me rastin e kryerjes së përmbarimit të urdhrin përmbarimor, përmbarimi është zbatuar pa vendosur ende Gjykata e Apelit të Kosovës, që ka shkaktuar direkt shpenzime shtesë në proces.

Gjykata Themelore në Prishtinë pas pranimit të ankesës për parregullsi nga ana e debitorit dhe për të vepruar tutje në këtë procedurë, me kërkesën e datës 04.08.2021, i është drejtuar Përmbaruesit Privat për kthimin e lëndës për procedim të mëtutjeshëm të kësaj çështje.

Përmbaruesi privat Ilir Z. Mulhaxha, me akt përcjellës për dorëzimin e lëndës në gjykatë, e ka kundërshtuar ankesën për parregullsi plotësisht si të pa bazuar, ndër të tjerash ka theksuar se urdhri P.nr.585/18 i datës 14.07.2018, është i formës së prerë pasi që debitori nuk e ka paguar garancionin e caktuar nga gjykata dhe lënda i është kthyer në kompetencë Përmbaruesit, e konform kësaj përmbaruesi Privat ka marr veprime për realizimin e borxhit dhe pas realizimit lënda është mbyllur A.A.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në ankesën për parregullsi të datës, deklarimit të përmbaruesit privat dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 79 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se ankesa për parregullsi e debitorit është në tërësi e pabazuar andaj të njëjtën e refuzoi dhe vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës gjeti se organi përmbarues/përmbaruesi privat nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim përmbarimor në mënyrë të parregullt dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret, debitori nuk e ka përmbushur obligimin e marrë me aktvendimin e PPP.nr.881/18 të datës 29.06.2020, ku me paragrafin II të dispozitivit është obliguar që në rast të paraqitjes së ankesës kundër aktvendimit, pala ankuese konform nenit 78 par.1 të LPP-së, paraprakisht të deponoj garancinë në të holla si parakusht për paraqitjen e ankesës, në të kundërtën gjykata konform paragrafit 4 të nenit të lartcekur, do të konsideroj se ankesa nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese, por meqenëse debitori nuk ka përmbushur obligimin e marr brenda këtij afati ligjor është konsideruar se debitori nuk ka ushtruar ankesë, përmbaruesi privat ka vazhduar me urdhrin për bllokimin e llogarive bankare të debitorit duke u bazuar në nenin 155 të LPP-së, me anë të së cilës janë transferuar mjetet e përmbarimit sipas urdhrin të lartcekur ndërsa me datën 22.03.2021, është nxjerrë urdhri për lirim-in-debllokimin e llogarive.

Sipas dispozitës së nenit 79. parag. 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se *“Pala ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë mund të parashtrorë një ankesë në Gjykatë, lidhur me parregullsitë që janë kryer nga organi përmbarues gjatë kryerjes së procedurës së përmbarimit. Kjo kërkesë i bëhet Gjykatës me një parashtrësë me shkrim në afat prej shtatë (7) ditësh nda dita e ndodhjes së parregullsisë së pretenduar.”*

Në rastin konkret gjykata vlerësoj ankesën për parregullsi të ushtruar nga debitori, por që e njëjta nuk ka arritur t’i dëshmoj gjykatës se organi përmbarues - përmbaruesi privat gjatë kryerjes së procedurës së përmbarimit ka pasur parregullsi, por që e njëjta është lëshuar në fakte tjera të cilat tani në këtë fazë të procedurës nuk janë relevante dhe nuk parashihen me dispozitën e lartcekur, e që këto pretendime debitori ka mundur t’i paraqes shkaqet e saj në ankesë sikurse ta realizonte këtë mjet juridik brenda afatit ligjor, por që në rastin konkret nuk e ka realizuar.

Meqenëse gjykata, nuk ka gjetur se ndonjë veprim përmbarimor është kryer në mënyrë të parregullt dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, nga ana e përmbaruesit privat, e të cilat do të ia cenonin dinjitetin e debitorit, gjykata vlerëson se përmbaruesi privat me veprimet e ndërmarra nuk ka kryer asnjë parregullsi dhe se i njëjti ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP-së, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 79 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08 L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1046/22, datë 21.06.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.